

URDHËR
Nr. 783, datë 29.12.2023

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
 - b) zogjve 24-orësh;
 - c) shpendëve dekorativë;
 - ç) materialit biologjik të shpendëve;
 - d) vezëve të shpendëve;
 - dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
 - e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.
- Nga shteti i Bullgarisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	*Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Dobrich	Dobrich-selska*	
2	Dobrich	Dobrich*	
3	Dobrich	General Toshevo*	
4	Pazardzhik	Pazardzhik*	

Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjtë 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 661, datë 10.11.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj